

AVNI MULAJ

ORËT E MIA

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

814-1  
M 98



POEZI

854-1  
M 88

AVNI R. MULAJ

# ORËT E MIA

*poezi*



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## BUZËQESHJE E RE E TOKËS SIME

Ja giza dhe çeliku ynë i parë!  
Ja dhe vargjet gëzimi i ligjshëm!  
Ja përpara meje  
toka ime metalurge!

Derdhur nëpër këto germa e fjalë,  
merr format e ëndrrave tona të mira,  
ti lavë e kuqe, e zjarrtë,

Këngë, fluturo sot  
në zemrat e bashkatdhetarëve,  
dhe si nektar mblidh krenarinë!  
Le të derdhet ajo nëpër germat e fjalëve  
si lavë e kuqe e metalit të saposkkrirë!

Si vagonat me minerale drejt furnaltave,  
kohërat drejt zemrave tona po vijnë,  
shkrihen ato në këtë buzëqeshje,  
që ka sot në fytyrë metalurgu ynë!

Shkrihet sot në metalin e parë  
trishtimi i nënave mbi furkat e drunjta,  
që sikur turrnin në to jo leshin e rudave,  
po hijet e këtyre maleve vigane!

Te metali ynë i parë,  
ç'nuk dëgjoj?  
Zëra në thellësi,  
vërshëllimën e kohërave,  
ulërimën e ujkonjës  
në instinkt uriegër,  
rreth kullës, bjeshkës,  
kufirit të trojeve!

Çdo gur  
sjell diçka të tillë me vete  
nga miniëra e largët në jug a verë,  
dhe qenka më e rëndë  
kjo peshë e dhembjes,  
se sa pesha e vërtetë e tij!

Ky metal, toka ime,  
është buzëqeshja jote e re;  
është dashuria jote  
për lirinë, dritën, jetën!

Janë te ky metal,  
duart e minatorëve,  
metalurgëve, makinistëve;  
është i mbrujtur ai  
me idealet komuniste!

Në hapat e ushtarit,  
gjatë do jetojë i vrazhdë  
imazhi i kafkës së armikut,  
duke shkelur gurët e ashpër-  
të bokave, bokërrimave,  
duke të ruajtur ty të paprekur,  
më të bukurën e buzëqeshjeve,  
proletaren!

Në turnin e tretë,  
toka jonë,  
nis metalit të saj të parë t'i flasë,  
si nëna fëmijës.

I flet  
me zërin e Mic Sokolit,  
me zërin e Selamit e të Vojos,  
që topin armik e kapën nga gryka,  
që mbi bunkerin nazist  
në përmendore u kthyen

Flet toka ime  
dhe ky metal i parë  
dëgjon e çuditet si fëmija,  
dëgjojnë dhe metali  
dhe metalurgët  
monologun e saj të dhimbshëm:

«Tyta të verbra ciklopikë,  
mbi qafat e maleve të mia,  
u nderën kohërave  
si stalaktide të tmerrshme  
Isha duke ëndërruar,  
duke prashitur,  
duke u ngjitur në bjeshkë,  
isha me fëmijën në gji,  
kur më qëlluan pa mëshirë.

Më besoni për gjithë plagët,  
vuajtjet, dhembjet,  
për gjithë ëndërrat.  
Edhe në emrin tuaj, breza të palindur,  
tytave të skuqura  
gjoksin ua vura  
edhe në emër të komunizmit.

Metali im!  
Brenda teje  
do jetë përherë zemra e metalurgut!  
Ti do të dish  
të qëllosh dhe të heshtësh,  
metali im!»

Kërkoje edhe ti, toka ime,  
të dije teknologjinë e shkrirjes,  
por përpara saj diçka tjetër duhej të mësoje,  
teknologjinë e të gjitha teknologjive,  
më të madhin mësim  
të të gjitha mësimëve —  
revolucionin, komunizmin!

Atë nëntor  
ti ngjisje shkallët  
e luftës dhe shkollës për komunizëm.  
Ti, luftëtar dhe nxënës i etur për dije,  
bërrylet e grisur vendosje mbi bankon e historisë,  
e jashtë, i menduar,  
vështroje natyrën në vjeshtë,  
me ngjyra të sfilitura,  
si fishkej e binte çdo gjeth  
e përmes gjithë ngjyrave  
zbulojë ngjyrën e kuqe,

përtëritëse të një pranvere  
me hove të përjetshme!  
Çdo gur minerali të fliste  
me nxehtësi furnaltash,  
damarët të ndizeshin,  
ne duart e metalurgëve  
minatorëve, makinistëve,  
duke t'u ndezur  
në përfytyrim të madhërishme  
veprat e pesëvjeçarëve.

Kështu ëndërroje,  
toka ime, më 8 Nëntor,  
ditën e themelimit të Partisë,  
ndërsa shoku Enver,  
biri yt, të fliste,  
me gjuhën e thjeshtësisë,  
për revolucionin e madh  
që nesër do ndizje!

Kështu me Partinë,  
populli im,  
shkonit përpara  
pa gabuar, pa ngecur,  
dialektikën marksiste-leniniste  
duke përvehtësuar



nga Nëntori në Nëntor,  
nxënës të zellshëm,  
krijues të guximshëm!

Në mendjen time  
lëkundeni vigje,  
ura të drunjta,  
të vjetra  
të vendlindjes,  
me rezonancën tuaj të dhembjes!

Lëkunden mbi këto vigje  
kohërat e tua të ikura,  
Shqipëri!  
Andej trishtimi i tyre iku,  
që kurrë të mos kthehet përsëri!

Peisazhe të së ardhmes,  
plot shkëlqim  
në mendjen time ndizeni,  
buzëqeshje njeriu  
dhe vezullim metali,  
nën diej që krisin frutat e djersës!  
Urat në qiell harkojnë,  
mbi shina trenat blu  
të ditëve fluturojnë!

Kohërat nën duart e metalurgut,  
xixa nxjerrin në kudhër!  
Ju që farkëtoni të ardhmen e ndritur,  
që lindni breza dhe metal shkrini,  
farkëtoñi dhe këto fjalë e ritme!  
Për metalin e së ardhmes  
që tani merrni zemrën time,  
këto vargje!

## TË UDHËTOSH NË MUZG

Të udhëtosh në muzg,  
duke u kthyer nga kombinati tekstil,  
me ritmin e makinave të tezgjahut në mendje.  
Të udhëtosh nën valsën e gëzuar,  
që hedh mbi qytete, fshatra, male, fusha,  
kukulla e varur në xhamin e makinës!...

Dhe një bisedë nis për të shkuarën,  
diçka intime nga jeta e një dëshmori,  
(thinjat në kokën e bashkëudhëtarit  
shkruanin diçka mbi peisazhet që fluturonin).  
Të udhëtosh në një muzg të tillë, ç'gjë e bukur,  
kur mbi mendimet e tua lëkundet një kukull  
si pendul i lumturisë njerëzore!..

## FËMIJËT E DURRËSIT DHE AMFITEATRI

Mëngjeseve zbresin shkallëve të mermerta,  
me çanta në duar, me sy të qeshur,  
në çantat e tyre gjeografia, historia, fizika,  
për të mësuar të lexojnë kohërat e shkuara,  
për të mësuar ecjen drejt kohërash të palindura...  
Mësojnë për tragjedira, epidemira, pushtime,  
për popuj, miqësira e armiqësira,  
për dijetarë, strategë, oratorë,  
për legjenda e mite,  
për vetë Kalin e Trojës...  
Nën zërin e mësuesit të tyre të historisë,  
lashtësia ngjallet, merr formë, zë e dritë,  
është naiv e i bukur koncepti i tyre  
«epokë guri» bronci, hekuri.  
Ata do të rriten dhe me sytë e komunizmit,  
krenarë do vështrojnë kohërat!

## KA QENË KY BUST KËTU NË ÇDO KOHË

Vështroj bustin e bronxtë të Mujos, këtij muzgu,  
me fytyrën nga deti si në kuvënd të përjetshëm,  
Në përfytyrimin tim ky bust rritet e rritet,  
statujë vigane e qëndresës sonë në shckuj!  
Ka qenë ky bust këtu me siguri në çdo kohë.  
Askush s'e kish gdhëndur, e mbinte vetë kjo tokë,  
si barin dhe lulet, si gjelbërimin e përjetshëm,  
Vinin vandalët, statujën pamëshirë e qëllonin,  
toka jonë me duart e saj sërish e lartësonte...  
Ka qenë ky bust këtu me siguri në çdo kohë!

## SHTËPIA ME QERPIÇ

Tani aty gjen vetëm qetësi,  
te porta e saj bojë kafe  
lozin ca fëmijë të lumtur.

Po kjo s'do të thotë,  
te çdo gjë e saj të mos ndjesh stuhinë...  
te doreza e derës,  
te tavolina dhe karriget,  
te gurët e mureve dhe të oborrit.

Shtëpi-muze tani,  
shtëpia e Partisë.

Ç'përshtypje të bën qielli i kaltër mbi të  
dhe ajo pema e vjetër në oborr,  
dhe ai numri mbi derën bojë kafe!

Tek ai numër,  
postën e viteve të revolucionit  
s'harron kurrë ta sjellë  
postieri bluzëkuq i të gjitha nëntoreve,  
tek ai prak ndjej të rezonojnë hapat e brezave,  
pikënisje e zërit tonë të lirë.  
ylberet e frymëzimit të gjeneratave shoh mbi të,  
pikim i përjetshëm i strehëve!

## NJERËZ TUNELESH

Tunelet në zemrat e maleve kokat zgjasin,  
zhibirim kolosal drejt dritës,  
heroizëm i madh t'iu ndrosh shtratin  
kësaj bote të lashtë, lumenjve të frikshëm...

Punëtorët e tuneleve janë njerëz të gëzuar,  
duke zhibiruar ata ndjejnë  
se hapin rrugë më të shkurtra,  
për të arritur në komunizëm më shpejt.

Në hyrje të tuneleve, në projeksion,  
përmes lëkundjes së shpatullave të tyre  
që në thellësi treten, ti botën mendon,  
më të sigurtë, më të bukur vetë jetën...

Për njerëzit e tyre këto tunele janë bota e madhe.  
Mesnatave të ftohta, kur thellësive ata kalojnë,  
ndjejnë mbi vete dritat e të-gjitha udhëve,  
gjumin e fëmijëve, uzinat që zhurmojnë.

## SHQETËSOHEMI

Në qenien tonë diçka zmadhohet përditë,  
është revolucioni.

Kemi në vete shqetësime të mëdha e serioze!

Na shqetëson edhe gruri që rritet fushave,  
edhe duart e punëtorëve tek përleshën me shkëmbin,  
edhe kënga jonë e re, duke lindur...

Drita e mëngjezit i fut në dhomë  
ato duar dhe grurin që rritet,  
thellësitë e tuneleve e galerive,  
pagjumësinë e bardhë të laboratoreve...

Ndiejmë botën e universin në qenien tonë,  
detra e oqeane e miliarda duar,  
sa hapësirë revolucioni na ka dhënë!

Shqetësohemi natyrshëm, për të gjitha,  
njëlloj si për thinjat në kokën e nënës,  
njëlloj si nëna për fëmijën...




## NËN GJUHËN E GJELBËR TË MISRAVE

Ec e ec përmes fushës  
më lëpinin gjuhët e gjelbra të misrave.  
Toka ish e butë, e shkrifët,  
merrnin në të jetë  
rrënjët e shëndetshme të bimëve.  
Lehtë mund ta kuptoje  
se toka ishte e lumtur,  
se ajo deshte të fliste,  
të thoshte gjëra të bukura,  
të thjeshta, të çuditshme,  
vetëm të heshtje e të dëgjoje!...

Ish një udhëtim tepër poetik,  
kish njerëz që udhëtuan me guxim  
drejt thellësive e lartësive,  
në të gjitha drejtimet.  
Më njerëzorja rrugë është kjo e jona,  
ku dallim mes fshatit e qytetit s'do ketë...  
Isha i dehur nga këto mendime

17



që gjuhët e gjelbra m'i zgjonin.  
Isha i tëri fëshfërimë e komunizmit  
nën diellin e ngrohtë të partisë sime.  
Ecja e ecja përmes fushës,  
kishin ecur njerëzit me guxim,  
ecin dhe do të ecin akoma më me guxim  
dhe në të gjitha drejtimet...  
Isha i tëri fëshfërimë e komunizmit!

## DJEMTË E MALIT

(poemë)

Përjetësisht me këtë emër mbetet!  
«Djem të malit»,  
ju, bijtë e nënave,  
dhe emër më të bukur nuk deshët!

Buzë lumenjve  
e përrenjve të vendlindjeve  
s'do të kishit rritje të qetë.

Malet u flisnin në gjumë,  
me shtigjet e rrahura  
e të parrahura në shekuj!  
Vinte zëri i tyre  
përmes lëmyshqeve e gjetheve  
nga rrudhat e të çarat e shkëmbenjve,  
nga ujvarat si mjekra!

Si ajo nëna që vendos karthijat në vatër  
dhe u fryn me kujdes gjersa ndizen,  
zemrat tuaja mblidhte nëntori  
një, dy, pesë,  
nesër mijëra e mijëra...

Nënat shihnin tek rritja shpejt e djemve,  
hijen e një ëndrre serioze,  
dukeshin në të ca shtigje të vështira  
që ata po i ngrinin jetës,  
shtigjet e nesërme të luftës partizane!

Nënat shihnin  
përmes trarëve të shtëpisë, natën,  
hijen e ëndrrës së tyre,  
që rritej e bëhej kolosale  
e s'e zinte më shtëpia.

Po rriteshin djemtë gjer te mali!  
Po rriteshin djemtë gjer tek ideali!  
Supeve të tyre ende të njomë,  
koha po u ngarkonte barrë të rëndë,  
supeve, që në ecje  
jepnin ngjashmërinë me baballarët!

Sa të vogël e ndienin veten nënat,  
për dashuritë dhe ëndrrat e tyre të mëdha!  
Shqetësoheshin  
dhe kishin besim tek ata,  
se do të dinin të ktheheshin faqebardhë.  
Sa herë i përcillnin nga portat,  
sa herë duart e tyre të lodhura, të mplakura,  
rrëshqisnin nga supet e djemve  
në çast ndarjeje!

Dhe bashkë me duart e nënave.  
edhe kullat dhe frëngjitë,  
edhe portat dhe avllitë,  
zgjatur rrinin drejt malit!

Një gjelbërim i ri po rritej lart në male,  
me rrinë e këtyre djemve dhe vajzave!  
Këto male përjetësisht mbi këtë tokë,  
kanë gëzuar pushtet mbi gjithçka  
në ndërgjegjen epike të kombit!

«Malet me blerim mbuluar»,  
këndojnë djemtë e malit,  
këndojnë nënat e djemve,  
këndojnë kështu gjithë hapësirat  
mes nënave dhe djemve!

Po rriteshin edhe nënat,  
përtej gjithë nënave të brezave,  
Ato nesër do ishin nëna heronjsh të mëdhenj,  
kështu edhe përmes këtyre nënave,  
kohërat madhështore po lindnin,  
gjersa ato kishin lindur të tillë djem!

Një e ardhme madhështore  
po ngjitej atje lart, në male,  
për të zbritur nesër  
në qytete e fshatra,  
udhë e lagje,  
kasolle të varfra.

Gjithçka po rilindte,  
gjithçka po rinohej!  
Portat hapeshin  
ditën e natën,  
gjithnjë e më shpesh.  
Ç'ish kjo erë?  
Këto hije ç'ishin?

Nëpër shtëpitë tona  
hynin malet,  
një tingull të çuditshëm

kishin portat dhe zemrat,  
këtyre netve ilegale!  
Historia jonë martire,  
portat përplaste,  
i thyente, i bënte fërtele,  
nga një erë e furishme!

Nën këtë erë të ngrohtë,  
nën këtë trokitje portash,  
si zambakët në kopsht,  
çelnin në gjumin e nënave  
plagët e djemve të malit...

Në gjirin e malit  
në gjumin e djemve,  
milionat porta mbylleshin, hapeshin,  
portat e të varfërve,  
portat e së ardhmes,  
portat e ditëve të bardha,

me kurora trëndafilash e drite,  
me zëra fëmijsh të lumtur,  
gumëzhitës...

Malet tanë gjyshër,  
me duar koskëforta,  
i merrnin trupat e djemve të vvarë  
në gjiret e tyre i varrosnin.  
Malet tanë stoikë,  
me dhembje të mëdha  
ngurtësuar nëpër shekuj!

Binin djemtë panumër!  
Shkonte shifra drejt 28 mijës!  
Po vinte dita e lirisë!

Shpejtojnë kohërat më të zjarra,  
nën thirrjet e komisarëve,  
te ky va i proletarëve!

Në këtë nëntor madhërisëm  
në oborin e Shqipërisë  
velloja së ardhmes i hiqej.

Beteja,  
si t'ju numëroj?  
Ju jeni shumë,  
pa numër,  
jug, veri,



**lindje, perëndim!**  
Në çdo pëllëmbë toke,  
Në sytë e të gjithë brezave  
ju do jeni një e vetme,  
Vaterlo për botën e vjetër!

Me gjakun tuaj të kuq,  
përjetësisht krenare do të flasë kjo tokë!  
Në symbylljen tuaj të fundit,  
ishim ne të palindurit,  
tani nën këtë qiell të kaltër,  
jemi ne dhe ju në sytë e njëri-tjetrit!

Në lëlëkuqet e plagëve  
ka qenë duke u çelur syri i së ardhmes,  
që s'u mbyll dot prej dhembjeve.

Ngrohtësia e gjakut tuaj,  
violinave të brezave do t'u duhej,  
që tingujt dhe frymëzimet të mos ngrinin.

Burime e gurra të malit!  
Përjetësisht do dëgjojmë te ju  
monologun e partizanit!  
Te vërshëllima juaj, pisha,  
baladën e gjakut të pastër!

Ju të gjithë së bashku, shokë,  
me jetët tuaja të flijuara, ngritët  
malin e madh të krenarisë së gjeneratave,  
malin e madh të dashurisë,  
malin e madh të nderit të nënave!

Ju kanë ngrirë këmbët nga të ftohtit  
në marshimet e gjata e të vështira,  
nëpër operacionet dimërore,  
thikë për thikë me kryqet e thyera;  
pyjet tona duke u zhveshur vjeshtave,  
mbi supe ju kanë hedhur gjethet,  
si gradën e thjeshtë të ushtarit të përjetshëm!

E ç'rëndësi ka  
si ra njëri apo tjetri,  
vendi ku ra?  
Kjo tokë nën hapat e marshimeve të tyre,  
ishte një pëllëmbë e vetme,  
një gjeth, një krua,  
një djep, një ninull...

Buzë shushurimës së lashtë  
të burimit,  
mbështetur pas armës tytënxehtë,

ashtu në gjysmëkotjen  
e mijëra kilometrave të përshkuara,  
duke folur diçka si në ëndërrim  
me violinat e brezave,  
sytë mbyllnin djemtë e paharruar!

Këtë symbyllje,  
monologun te burimi,  
djepin që lëkundej në mëndjen e tyre,  
një letër të shkruar për nënën  
të gjitha nesër do t'i ndjenim  
në tingujt e violinave,  
në zjarrin e poemave!

## KANTIERET

Ca baraka të thjeshta në fillim  
me dërrasa pupulit e katran,  
ca fjetore e mensa,  
ca zyra ku klasa flet pa drojtje.

Kështu shpejt e shpejt të ngritura,  
në grykat e lumenjve tanë të nxituar,  
mbi fushat tona rrahur nga troku i luftërave  
nëpër shekuj i pambaruar.

Përmes thjeshtësisë së tyre të madhe,  
e ardhmja komuniste ndihet në afërsi,  
përmes tyre si diell i qeshur mbi botë  
shfaqet fytyra e njeriut tonë të ri...

## SIRENA

Sirena të bardha! Në mëngjes, mesnatë, mesditë  
të anijeve që hyjnë në port, ose që largohen  
të trenave të pasagjerëve e të mallrave, papushim,  
sirena të punës, sirena të qytetit tim,  
një portë ëndrrash lini hapur tek ne.  
Janë shkrirë me ju të gjitha gëzimet e shqetësimet,  
dashuruar jam me ju si fëmijët e këtij qyteti.  
Sirena të bardha! Gjithmonë të gëzuara rënshi!

## ÇILTËRSI

Është i bukur lumi i kaltër.  
Poshtë nën ujë duken të gjithë gurzit,  
të gjithë peshqit që notojnë.

Është i bukur sinqeriteti  
përpara tij e ndjejmë veten  
si përpara lumit të kaltër...

Në ujin e turbullt dhe shpirtin e molepsur  
nuk pasqyrohet dot asgjë,  
as gurët e bardhë, as peshqit, as yjet...

## M E T Y

Këto ditë jam bashkë me ty.  
Tani e kuptoj, ka ndryshuar vetja ime,  
me të dielat, të mërkurat,  
të premtet e të shtunat...  
Tani më shumë i dua detin, njerëzit, fëmijët,  
askush të mos mendojë se portat ua mbyllëm.  
Ne, duke dashuruar njëri-tjetrin,  
me të ardhmen më shumë jemi lidhur...

## AJO SHKON NË MINIERË

Ajo shkon në minierë,  
miniera është larg në veri,  
inxhiniere e sapodiplomuar  
tani me jetën do njihet më mirë!

S'ish e hutuar kur mori valixhen,  
me ca ndërresa e libra  
as kur pa se dikush i shprehu dhimbje,  
me ca fjalë që të kohës s'ishin.

Ajo valixhen krenare e mbante  
koha në sytë e saj triumf i bukur!  
Në këtë ndjenjë të saj plagët e veteranëve,  
çuditërisht ndjeheshin të lumtura!

Përmes siluetës së saj vështroja hapsirën,  
përmes valixhes së saj që lëkundej  
pika e lotit mikroborgjez, të turbullt,  
nga syri i dikujt binte në qelqin e qiellit.



## NYJET E VARGJEVE

*(Kushtuar poetit dëshmor Kristo Isak)*

Unë shkruaj vargje në tjetër kohë,  
kur qetësisht lidhen mbrëmja e mëngjesi  
mëngjesi dhe mesdita,  
qetësisht dashurohen vajzat e bëhen nëna,  
qetësisht lindin fëmijët e u vihen emra...

Nga mendja s'më hiqet dorëshkrimi  
me vargjet e poetit dëshmor,  
boja vende-vende shlyer,  
letra zverdhur  
dhe ndonjë fjalë a rresht lexohej me zor...

Fjalët drejt e nga lufta vinin,  
kudo ndihej mes tyre  
heshtja solemne e vendimit më të madh,  
e vetmohimit të ndërgjegjshëm.

Në çdo germë,  
rrokje, presje, pikë,  
armiku i tokës  
dhe gjuhës sonë,  
kish zënë pritë . .

Me fjalët në mendje  
ecja rrugëve,  
sikur me gjithçka  
vargjet e poetit t'i prezantoja.  
Nën dritën e neoneve sikur shihja  
konstruktet e çuditshme të tyre!

E përfytyroj mes dhomës së tij!  
Djalosh i ri,  
krahërorin plot ëndrra,  
përkulur mbi letër rri.  
Le të ish vdekja duke ngjitur shkallët,  
duke shqyer derën me kondak,  
suvaja copa-copa duke rënë,  
ai s'do të vdiste kurrsesi,  
këto vargje, së paku pa na lënë!

Mes heshtjes së dhomës,  
shpesh do i jetë dukur,  
se dikush «Kristo» ka thirrur,  
sikur vetë muret të flisnin  
në netët ilegale të luftës,  
kur apelonte liria, komunizmi!

Sonte kudo është pranvera dhe liria,  
te gonxhet që çelin në kopsht.  
Diku te një nga këto mijëra dritare  
është silueta e një djali të vogël,  
mbi violinë duke improvizuar diçka...  
Ndjej vargjet e poetit n'ata tinguj!

Sonte jeta shëtit e qetë kudo!  
Sonte unë ndihem besë dhe vazhdim!  
Te themelet e ndërtesave, te dritat,  
te monumentet e bardhë,  
te trëndafilat që çelin kopshteve,  
janë kudo nyjet e vargjeve tanë!

## NJË FJALË DHE JETA IME

### I

Shumë fjalë të bukura mësova në jetë  
me tingëllim të ëmbël si muzikë,  
që shpirtin tim njëlloj e patën dehë  
sado që mijëra herë qenë përsëritë.

Një natë dimri plot vetëtima,  
pata lexuar diku në një libër  
fjalën e panjohur «Komunizëm».  
Asnjë shok imi asgjë për të nuk dinte!

Ç'e pat ndezur fantazinë time,  
që kuptimin e vërtetë t'i gjente.  
Përmas' e saj kalonte bjeshkën, vrririn,  
kalonte moshën, hovet e guximin!

### II.

Te fjala komunizëm si të hyja?  
Ajo ish bjeshka e panjohur për mua,  
dhe si më lehtë së pari gjyshen pyeta:  
— O gjyshë, për këtë fjalë, diç as më thua?

Po gjyshja, që mendoja se do dinte,  
për të asgjë nuk mundi të më thotë,  
veçse njëfarë inati sikur kishte  
se do na linte pa qe e tokë.

Sepse kështu dikush i kishte thënë,  
armiku i klasës kishte shfryrë,  
apo e shoqja e hoxhës sonë të fshatit,  
që ai do prishte, bile, dhe xhaminë.

Dhe çdo shpjegim që ndodhi të më jepnin,  
ndryshonte nga ngjyrat e fantazisë sime,  
por u mësova atë më mirë ta njihja,  
edhe përmes sharjesh e mallëkimesh...

Ta kuptoja lidhur me trarët e nxirë,  
lidhur me arnat e opingat e grisura,  
lidhur me vdekjen e shokëve tanë të rinj,  
pa i gëzuar jetën, lodrat, librat.

Lidhur edhe me nënën e babanë,  
që nga skamja ndoshta aq shpesh grindeshin,  
lidhur me motrën e vogël që duke qarë,  
i thaheshin qerpikët e zes e të bukur!

Mësova kështu gjerësitë e komunizmit,  
ti gjeja, o shokë, edhe te gjërat e thjeshta,  
te fushat e reja pa megje e kufij,  
te lumturia e madhe e të gjithëve!

Mësova mijëra e mijëra kuptime,  
dhe ndryshe i lexoja rrudhat e baballarëve,  
dhe ndryshe e lexoja pastaj tokën time,  
dhe ndryshe ëndërroja të ecja përpara!

E ndesha më qartë me kolektivizimin,  
fillova për të të recitoja vjershat e para,  
gjithçka më të dashur që kisha,  
e vura një ditë brenda kësaj fjale!

### III.

Kaq e gjerë ishte kjo fjalë e kuptoja,  
sa mund t'i zinte vendlindjet të gjitha,  
gjithë ëndrrat e fëmijëve, gjithë bota  
brenda saj lirshëm mund të rrinin.

Dhe ditën kur kapërceva kodrat e vendlindjes,  
ish zgjatja më tutje e dashurisë për fjalën  
që kisha njohur në të hershmet vite,  
të hoveve në zgjime, të ëndrrave valë.

Ish udha e gjatë, e vështirë, e pafundme,  
ku ajo do t'i shpaloste përherë bukuritë,  
si diell do qëndronte ajo mbi gjithë fjalët,  
si dashuri sublime mbi të gjitha dashuritë!

## LAGJA E MARGARITËS

Rrëzë kalasë së lashtë, në monopati, .  
si një tufë delesh të bardha  
shtëpitë e lagjes Mangalem,  
si të qepura me njëra tjetrën, çatitë, muret,  
pullazet...

Përjetësisht atyre që do të vinë këtu, do t'ju duket  
se tek njera prej këtyre dritareve shohin fytyrën  
e Margaritës.

Udhëve me kalldrëm do t'u duket se dëgjojnë,  
çapet e vogla të saj me jehonën e përjetësisë.



## TË DY NËNAT

Te një kullë diku në veri,  
në duart e një nëne malësore,  
mbyllte sytë  
partizani i plagosur.  
Ish kohë e ashpër,  
kështu ndodhte me të gjitha nënat tona.  
Njëra në veri,  
tjetra në jug,  
s'ka gjë në mbetën të panjohura,  
ato ishin nënat e revolucionit!

## ALEKSANDËR MOISIUT

Në shumë skena të botës ke luajtur,  
aktor i madh me origjinë shqiptare,  
kur atdheu yt s'kish dhe një të vetme,  
veç maleve të tij plot tragjedi e halle.

Kur ujçërit natë e ditë pa mëshirë e copëtonin,  
kur nën dritën e pishës në kullat malësore  
luante drama e dhimbshme e urisë dhe errësirës  
në skenën e prapambetjes shekullore.

Te forca e Hamletit tënd ish dhe atdheu yt.  
Me zërin tënd thërrisje malet e tua,  
thërrisje foshnjat të mos vdisnin, të lindnin!

Duhej të luaje, të mos vdisje pa luajtur,  
emrin e atdheut tënd më lart kështu e ngrije,  
tek përpiquej dhe ai të lindte të ardhmen!

## ORËT E MIA

Të mëdha janë orët e mia në revolucion.

Ka kohë për punë, dashuri, projekte, ëndrra,  
vetëm për soditje dhe pasivitet s'ka.

Përmes tyre lëviz furishëm transformimi vigan,  
nën oshëtimën e gjakut s'dëgjohet penda kur lëviz. . .

Krismë e madhe je, toka ime, që komunizmin po lind.

## LEJLEKËT

Mbi shtyllat e tensionit të lartë  
ngritën foletë lejlekët.  
Ndoshta bota e tyre e lashtë  
kështu aprovonte hekurin!

## DURRËSIT

Linja të buta nga deti te kodrat,  
që dhe në shpirt të tilla janë fiksuar.  
Duke ardhur drejt teje, duke ikur,  
në to vetveten kam lexuar e rilexuar...

Nën këto linja të kaltra e gri  
flenë kujtimet, pasionet, dashuria,  
gjërat harrakate, çapkënlleqet me shokët,  
mbetur kanë dhe ato në këtë filtër.

Kështu shkrirë jemi me këto linja,  
për të lexuar në to vetveten  
sa herë drejt teje do të vinim,  
sa herë të largoheshim prej teje...

## A P O L L O N I 1975

Mbrritëm në Pojan; qetësi.  
Nën fiq, nën ftonj, nën ullinj,  
fshihej e bardha lashtësi.

Nga kënde të ndryshme, diçka të fiksojnë  
vajzat piktore u shpërndanë,  
gjithë buzëqeshje ishin, gjithë humor.

Me pantallona, flokë të prerë,  
aspak të ngjashme me perënditë,  
duke i buzëqeshur lashtësisë.

Unë përpiqesha të kuptoja këtë ndjenjë të tyre,  
vallë, të ishte kjo ndjenjë  
sekreti i ëmbël i vazhdimësisë së kohës?!

## V J E S H T Ë S

Drurët frutorë anës rrugëve  
duken të lodhur, të dobësuar,  
si ato gratë lehona të sapolindura,  
kalimtarit i ngjallin respekt e dhembje.

Peisazhet në fluturimin e stinës  
kanë një zhaurimë të çuditshme.  
Erërat që pas xhamit vërtiten  
kërkojnë të na lënë pa gjumë,  
duke derdhur mbi ne pikimin  
e mollëve, gështenjave, kumbullave...

Prej strehëve të stinës, bien  
miliona pika të verdha...  
Në imazhin tonë me fruta  
ngjasin pikat e djersës.

## KËTO SIRENA TË SË DIELËS

Këto sirena të së dielës,  
të trenave, që bartin njerëz drejt plazhit,  
si të etura ngjajnë,  
si të zhuritura,  
riten e riten gjer në diell!

Dhe toka zgjat buzët  
e verdha, rënore,  
te bluja e detit  
si fëmija në sisë.

Gjithçka e kërkon detin sot,  
si unë e ti njëri-tjetrin!



## PËRGJONTE HELMETA E NDRYSHKUR

Një natë vere rrinim në verandë.  
U gëzohej oborri zërave të fëmijëve,  
emisionet e radios ndërroheshin  
lajme, muzikë, lajme sërish,  
diku në botë, afër apo larg,  
ishte bërë një shpërthim i ri atomik.

Në fund të oborrit mbi një hu,  
përgjonte helmata e ndryshkur,  
sikur vajtonte prej vitesh  
kafkën që e kishte mbajtur dikur,  
që s'dihej tani ku do ishte  
nën shi dhe diell.  
Në kavitetet e saj, në vend të truve,  
ndoshta strehohej ndonjë kërmill...

Përgjonte helmata bisedën tonë,  
përgjonte gëzimin e fëmijëve,  
përgjonte botën te zëri i spikerit,

ndiente se s'kish vdekur, e thërrisnin  
larg instinktët e vjetra.  
Shihte diku helmët të tjera fringo,  
që një kohë tjetër i fabrikonte.

Në vend të dy «S»ve të thyera,  
simbole të tjera ato kishin,  
veç e njëjta kafkë ishte.  
Ne helmëtën përgjonim,  
të ngrinte krye s'e linim!

Kaq vjet kishin kaluar, dekada,  
Luftën e dytë tani e gërmonin  
historianët, regjisorët, shkrimtarët,  
politikanët, diplomatët, veteranët  
dhe nxirrnin prej saj motive, idera,  
siç gërmohet brenda një miniere!  
Ndërsa xhaja tregonte: «Pas derës,  
ja aty, me sëpatë e qëllova. . .»  
dhe sytë e tij hapnin korridore  
përmes viteve e erërave. . .

Çdo kodrinë, çdo pëllëmbë toke,  
flet akoma me zë të ngrohtë.  
Sytë tanë dhe sytë e popujve përgjonin

lëvizjen e helmetës nëpër botë,  
që të mos shfaqeshin më në cep të çdo rruge  
si dje mustaqet e Hitlerit,  
sfinkse të zinj të kobshëm!

Rrinim në verandë e bisedonim  
përgjonte helmata e ndryshkur...  
Në diell do rreshken kafkat e agresorëve  
të destinuara për strehë kërminjsh.

## KATET DHE FURTUNAT

### I

Ja, ky restorant dhe ky hotel  
dikur kanë qenë pronë e tij,  
shqetësim tjetër s'kish zoti Mikel  
veç fitimeve dhe gruas së tij.

Jashtë grilave të gjelbra të dritareve,  
në rrugë ndërronin stinët e motet  
dhe furtunat shfrynin makabre,  
ndërsa brenda vilës paqja mbretëronte!

Le të ish në të gjithë botën krizë!  
Për njeri shumë i zoti njihej ky Mikel,  
gruaja e tij, bukuroshe plot dritë,  
e bindur ish se bënte dhe për president.

Zhaurima e furtunave te grila përplasej,  
grindej ajo me të brendshmen paqe,  
që thurrej ëmbëlsisht me tinguj pianoje,  
me valse, uvertyra dhe arie...

Flokët e tij shkëlqenin prej brilantinës  
dhe bardhësia e damës nuk e ndiente kohën,  
ndërsa në luftë me vdekjen e mjerimin  
ropateshin shtresat e gjera të popullit.

Në krevatin dopio shpesh para gjumit,  
pronari Mikel dhe dama e tij bardhoshe  
kishin dëshirë të filozofonin, sipas tyre,  
për furtunat, përmytjet dhe botën.

Dhe frikë u ngjallnin klithmat e erërave,  
shkulmet e shirave dhe të gjetheve,  
toka që u dukej se po merrte  
pamjen e një vullkani.

## II.

Nga kati i dytë në katin e parë,  
dhjetë shkallë, vetëm dhjetë shkallë,  
i zbriste zoti Mikel ngadalë  
dhe hynte hijerëndë në kuzhinë, në lokal.

Në derë të restorantit shfaqeshin  
lypësa të uritur për tmerr, të leckosur,  
i shtynte aty furtuna e barkut,  
për të cilën bisedonin bashkëshortët lart.

### III.

Furtunat të mençura po bëheshin në botë,  
dikush sy po iu vinte në ballë,  
parandjenin katet e lartë  
frikën e një tërmeti shtatë ballë.

Po dama e tij atje sipër s'besonte  
veç në lumturinë e saj, asgjë në botë.  
Katet e tyre si mund të rrëzoheshin,  
lumturia e tyre si mund të binte në tokë!?

Zoti Mikel kish kohë, s'ish i qetë,  
paqja e konfortit të tij ishte krimbur,  
shihnte ca ëndrra të tmerrshme ku kazanët  
fluturonin si planete në kokë t'i binin!

Dhe shkëlqimi i mobiljeve i trishtuar,  
dhe ai vizatimi misterioz i rimesos  
sikur shprehnin diçka të patreguar,  
ca peripecira të reja nëpër vija e leqe! . . .

Nëpër ato vija natën, nën dritën e zbetë,  
sikur lexonte të ardhmen e turbullt,  
i bëhej sikur lart nga qiejt,  
si një breshër binin katet e tyre!

#### IV

Një ditë furtuna hyri gjer në kuzhinë,  
gjer atje, te kazanët e gjellës,  
dhe shoku Mikel përfundoi mrekullisht  
në lokalin e tij kamerier.

Erdhi një kohë që s'i pranonte bakshishet,  
për shokun Mikel kjo ishte e vështirë,  
për një dhjetëqindarkësh dridhej e spërdridhej,  
tundohej së tepërmi ndërgjegja e tij.

Lufta kundër bakshisheve në kolektiv  
e ashpër vazhdonte me kritikë të rreptë,  
në ëndrrat e Mikelit çdo natë-  
zmadhohej dhjetëqindarkëshi, bëhej qiell, det. .

Në gjumë sërish kohërat e ikura i shfaqen,  
mobiljet e vjetra e kanë humbur shkëlqimin,  
vijat e rimesos nën reflekset e dritës,  
janë udhë që nga e shkuara e kanë drejtimin.

.....

## NGROHTËSI E PËRJETSHME

*Kushtuar Heroit të Popullit Met Hasa, partizanit  
15-vjeçar që ra në luftë me nazistët gjermanë.*

Vrapoj përmes shkëlqimit të kësaj dite pranverë,  
përmes buzëqeshjeve të çiltra të fëmijëve,  
përmes syve që i ngazëlleen kësaj drite,  
vrapoj të gjej për këto vargje  
ngrohtësinë e përjetshme të plagës sate.  
Për këto vargje që njerëzit i presin,  
njerëzit e mirë që s'dinë të harrojnë,  
që dinë me zemrat e tyre të japin përvdekësinë.

Pesëmbëdhjetë pranverat e tua  
të ndezura me ëndrra komunizmi,  
përpiqem t'i gjej sot kudo  
te bukuritë plot shkëlqim të kësaj dite.  
Pesëmbëdhjetë pranverat e tua,



tufë lulesh që shumëfishohet në duart e njerëzve,  
njerëzve, që vazhdojnë përpjekjet, qëndresën,  
që ngrenë fëmijë paraduash,  
e njerëzve që te mermeri juaj bëjnë homazhe,  
me atë heshtjen ku janë nyjet e sigurta të kohërave!...

Pesëmbëdhjetë pranverat e tua!  
Shpejt në to u rrite e u burrërove,  
u rrite përmes tyre gjer në komunizëm!  
O vogëlush, me kujtim të çuditshëm!  
Ndoshta pakkush atëherë mund ta dinte  
se ato pranverat e tua mund të ishin aq shumë.

Pesëmbëdhjetë pranverat e tua,  
sa lugina mbajnë, sa male e fusha,  
sa qytete e fshatra, nën hapat e vegjël,  
nën hapat e mëdhenj të heroizmit;  
pesëmbëdhjetë pranverat e tua  
hapësirë e pamatshme veçse nga kënga!  
Ne vrapojmë përmes saj e rritemi!

Në një botë të tërë të përgjakur,  
helmetën me kryq të thyer  
e ndiqte dhe një vogëlush shqiptar,

me të pesëmbëdhjetë pranverat e tij,  
simboli më i bukur i pathyeshmërisë  
së popullit të vet që e lindi!

Përmes shkëlqimit të kësaj dite pranvere,  
përmes buzëqeshjeve të çiltra të fëmijëve,  
vrapoj të gjej ngrohtësinë e plagës sate  
për të çelur bisqet e kësaj kënge. . .  
Ajo plagë montuar diku si dielli  
dhe ngrohtësinë e përjetshme u jep viteve!

## V A H E T

Zhurmë valësh  
mbi zalle të shkretë të pashkelur!  
Dritë hëne mbi hapa të vetmuar!  
Një shpend që klith në ajër,  
një këtu, një atje,  
rrjedhës së lumenjve,  
vahet!

Vetëm punëtorët e hidrocentraleve  
e njohin poezinë e tyre  
më bukur se kushdo,  
në mënyrën më reale.  
Siluctat e tyre me xhakëtë supeve  
mbi konturet e shtrembëra të maleve,  
i njih tashmë dielli dhe hëna...

# LULET E KOHËS

(poemë)

I.

Në hartë  
tjetër është t'i shohësh gjërat.  
Atje tmerrësisht gjithçka integron.

Shumë gjëra atje shuhën, fshihen,  
nën shenja konvencionale fshihet bota,  
udha jote ku ti ecën çdo mëngjes,  
që ia njih edhe cicërimat e zogjve.

Dhe te shifra e popullit tënd,  
emri yt përballë botës rri.

II.

Vështroj hartën e botës,  
ja Atdheu im, Shqipëria!  
I vogël buzë Adriatikut,  
madhështor buzë së ardhmes,  
i kuq buzë komunizmit!

Vështroj krenar me sytë e tij,  
flas krenar me zërin e tij!  
Te ky zë çeli gonxhet e ardhmja,  
te ky zë je ti, botë  
e drejtë dhe e bukur!

### III.

Si në pyllin e dendur  
shtyjme degët e mpleksura  
për të hapur udhën,  
shtyj në hartën e botës  
densitetin e ngjarjeve,  
të fshehtat e diplomacive.

Këtë koracë të gurtë,  
që botën stërmundon e shtyp,  
me ndryshkun burokratik të shekujve,  
shtyj me fuqinë shpërthyesë të gonxheve,  
të luleve, të plagëve të së drejtës,  
që çelin meridianeve e paraleleve.

Nga ato thellësi  
nuk nisen avionet,  
që lëvizin presidentët e politikanët,

nga ato thellësi  
nuk burojnë agresionet, sherret,  
në ato thellësi  
janë embrionet e së ardhmes!

#### IV.

Vështroj hartën e botës,  
ja Atdheu im, Shqipëria!  
I vogël buzë Adriatikut,  
madhështor buzë së ardhmes,  
i kuq buzë komunizmit!

Qëndrojmë, kundërshtojmë diktatet,  
superfuqitë s'i përfillim!  
Si ka mundësi, ku bazohemi vallë?  
Ku i kemi forcat, si i llogarisim?

Mbi relievin e ashpër të botës,  
me një pyetje të tillë,  
ravigjzohen dy sy skllavi,  
dy sy të mjeri, të nënshtruari,  
me një ironi të zezë mes tyre!

Si t'ua shpjegoj pamposhtjen tonë  
të nënshtruarve,  
vasalëve e gubernave,  
që as zërin as sytë s'i kanë të tyre?

Pamposhtja jonë  
ka rrënjë të thella,  
të fuqishme,  
përtej fuqisë së atomit tuaj,  
përtej shpejtësisë së raketave tuaja,  
i ka rrënjët tek e ardhmja!

V.

Lule të kohës, mirë se vini  
me shpërthimin tuaj të gonxheve!  
Freski e oqeanëve, dashuri e popujve,  
mirë se vini qetë dhe madhërishëm!  
Të pagjuma, pak të lodhura, të tymosura,  
duke e dashuruar botën në mënyrën tuaj!  
Mirë se vini!  
Çdo sekondë, minutë,  
orë, ditë  
ka rekëtimën e çeljes suaj!  
Qenia jonë është e mbushur  
me kumbimin tuaj të afërt e të largët,  
netëve e ditëve,  
edhe kur puthim fëmijët,  
lëngun e petaleve tuaja kemi në buzë!

Zmadhohet zemra jonë,  
zmadhohet bota,  
besimi!

Vini gjithnjë buzëqeshur,  
buzëqeshjen e botës duke shtuar,  
dëshmi e qartë  
se dashuria jonë është reale!

I shtoheni zëris  
dhe pamposhtjes sonë!  
I shtoheni së ardhmes,  
së vërtetës  
dhe bukurisë sublime të botës!

Te secila prej jush kur çelni  
jemi edhe ne me lulet tona!

Mirë se vini, lule të kohës,  
me shpërthimin e papërmbajtur të  
gonxheve!

Duke çelur pa mëshirën e askujt,  
pa lëmosha,  
jashtë vilave të mykura,  
salloneve pompoze,  
ku rriten lule të fishkura, të sëmura,  
që në aromat e tyre kanë hidhërimin  
dhe në ngjyrat e tyre  
trishtimin e vdekjes!



Mirë se vini,  
Dashuri e popujve,  
freski e oqaneve,  
pamposhtje e botës!

## VI.

Ne rrisim lulet e dashurisë besnike,  
ne nuk i rritëm lulet tona si dikush  
që nesër me të të shkonim  
në takime të turpshme tradhtarësh,  
siç shkojnë sot Brezhnjevët te reaksionarët.  
Tek ato buqeta ndjejnë rrëqethje të rënët!

Punojmë më shumë,  
vigjëlojmë,  
i japim kësaj kohe  
diçka edhe nga dashuria e fëmijës,  
që lulet tona kurrë të mos vyshken,  
që armiqtë të mos thithin aromën e tyre!  
Jemi krenarë, e kemi krenarinë në shpirt,  
sepse jemi pjesë e pamposhtjes së botës!

Mirë se vini, lulet e kohës,  
duke lënë pas  
çudinë, habinë, mosbesimin,

trishtimin dhe urrejtjen e dikujt  
dhe bujën e atomit,  
bakteriologjinë dhe napalmin,  
konferencat dhe bisedimet;  
mirë se vini te besimi real  
i botës reale!

## VII.

Vështroj hartën!

Prek flokët e vesuar të Atdheut,  
duart e shokëve e miqve pa numër,  
dhe jam krenar  
që edhe tek Atdheu im i vogël,  
ka diçka madhështia e së ardhmes.

## PASQYRA E LËNDËS

Buzëqeshje e re e tokës sime .....	3
Të udhëtosh në muzg .....	11
Fëmijët e Durrësit dhe amfiteatri .....	12
Ka qënë ky bust këtu në çdo kohë .....	13
Shtëpia me qerpiç .....	14
Njerëz tunelesh .....	15
Shqetësohemi .....	16
Nën gjuhën e gjelbër të misrave .....	17
Djemtë e malit (poemë) .....	19
Kantjeret .....	28
Sirena .....	29
Çiltërsi .....	30
Me ty .....	31
Ajo shkon në minierë .....	32
Nyjet e vargjeve .....	33
Një fjalë dhe jeta ime .....	36
Lagja e Margaritës .....	40
Të dy nënat .....	41
Aleksandër Moisiut .....	42
Orët e mia .....	43

Lejlekët .....	44
Durrësit .....	45
Apolloni 1975 .....	46
Vjeshtës .....	47
Këto sirena të së dielës .....	48
Përgjonte helmata e ndryshkur .....	49
Katet dhe furtunat .....	52
Ngrohtësi e përjetëshme .....	56
Vahet .....	59
Lulet e kohës (poemë) .....	60